Gjysmëfinalja e dytë: Man Utd vs. Arsenal

16 04 2009

Ndeshja kthyese çerekfinale e Ligës së Kampionëve e zhvilluar të mërkurën mbrëma në Estadio do Dragao, ndërmjet Portos dhe ter Unitedit, ka përfunduar me fitoren minimale të Djajve të Kuq, të cilët me këtë fitore janë kualifikuar në gjysmëfinale.

Takimi i parë i zhvilluar në Old Trafford përfundoi me rezultat të barabartë, 2-2, prandaj kampionët në fuqi i kualifikonte cilado fitore, apo cilido barazim me më shumë se tre gola, ndërsa rezultati i njëjtë (2-2) i dërgonte skuadrat në vazhdime.Pjesa e parëDjajtë e Kuq e filluan ndeshjen furishëm duke qenë kërkues të golit që në minutat e para dhe shumë shpejtë e arritën qëllimin e tyre.

Ishte lojtari më i mirë në botë për sezonin e kaluar, Cristiano Ronaldo, i cili gjuajti nga një distancë prej afro 27 metrash, duke shënuar një supergol në portën e portierit Helton (6’).

Pas golit të pësuar vendasit e morën e veten dhe për disa minuta krijuan presion para portës së Van der Sarit, mirëpo përveç disa rasteve të pakonkretizuara, ata nuk arritën të bëjnë asgjë.

Nga ana tjetër, në minutat e fundit të gjysmës së parë, Porto ka mundur të ndëshkohet sërish, nëse Vidic do të ishte më i saktë në portën e zbrazët (43’), por serbi gjuajti mbi portë.

Sido që të jetë pjesa e parë përfundoi me avantazh minimal të Djajve të Kuq, rezultat i cili i dërgonte kampionët në gjysmëfinale.Pjesa e dytëMinutat e para të fraksionit të dytë të lojës ishin të zbehta sa i përket rasteve duke qenë se United e dëshironte këtë rezultat, ndërsa vendasit nuk mund të organizoheshin para portës mysafire.

Megjithatë në njëzet minutat e fundit të ndeshjes Porto pati iniciativë të plotë, por lojtarët vendas nuk mundën ta thyenin mbrojtjen e pathyeshme të Djajve të Kuq, e cila me kthimin e Rio Ferdinand, ishte e pakalueshme.

Portos do t’i mjaftonte një gol që të vazhdonte më tutje, mirëpo këtë nuk e bëri dhe u eliminua.

Kështu, Manchester United kualifikohet në gjysmëfinale pas fitores së përgjithshme me rezultat 3-2. Në gjysmëfinalen angleze, United do të takohet me Arsenalin.Topçinjtë natën e sotme e kanë mposhtur Villarrealin në Emirates me rezultat 3-0 duke u kualifikuar në gjysmëfinale me rezultat të përgjithshëm prej 4-1.